

SIGURIMI I PERGJEGJESISE PROFESIONALE

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT

1. Mbulimi ne sigurim:

Kjo police, bazuar ne kushtet e pergjithshme, percaktimet ne policën e sigurimit, perjashtimet dhe kufizimet do te demshperbleje te Siguruarin per te gjitha demet e shkaktuara paleve te treta si pasoje e pergjegjesise profesionale te te Siguruarit.

Çdo kërkesë për dëmshpërblim e palës së tretë duhet:

- i) Te jete per deme me qellim marrjen e kompensimit, ku do te perfshihen shpenzimet e pales se demtuar;
- ii) Te jene ngritur kundrejt te Siguruarit pergjate periudhes se sigurimit;
- iii) Te jene deme qe rrjedhin nga nje veprim, gabim ose mangesi si pasoje e neglizhences, te kryera nga i Siguruari pergjate periudhes se sigurimit
- iv) Te kete ndodhur si pasoje e kryerjes se zakonshme te permbushjes se sherbimeve profesionale nga i Siguruari.
- v) Te kete lidhje me nje veprim, gabim ose mangesi si pasoje e neglizhences, te cilat mund te kene ndodhur pas dates mbrapavepruese te percaktuar ne formularin e polices.

2. Limiti i demshperblimit

- a) Vlera totale e demshperblimit (qe perfshin shpenzimet e paleve te treta te demtuar) qe i Siguruari mund te perfitoje nga kjo police per te gjitha demet e ndodhura pergjate periudhes se sigurimit, nuk do ta kaloje asnjehere limitin e demshperblimit ne agregat te shenuar ne formularin e polices.
Limiti i demshperblimit nuk do te rritet edhe ne rast se ne formularin e polices percaktohen më shumë se një i Siguruar, dhe as nese padite kryhen nga me shume se nje person ose organizate.
- b) Siguruesi mund te paguaje te Siguruarin ne cdo kohe per deme ndaj paleve te treta ose seri demesh deri ne limitin e percaktuar ne formularin e polices. Ne rast se ndodhjes se me shume se nje demi pergjate periudhes se sigurimit, shuma e demshperblimit/ve do te zbritet/n nga limiti i percaktuar. Ne qofte se i Siguruari do te kerkoje te rivendose limitin fillestar te demshperblimit, atehere duhet te paguaje nje prim shtese te llogaritur nga Siguruesi.

3. Trajtimi i demit

Siguruesi merr persiper qe te trajtoje te gjitha kerkesat per demshperblim, te cilat jane objekt i polices se sigurimit, lidhur me padite e ngritura ndaj te Siguruarit. Siguruesi do te trajtoje te gjitha kerkesat e siperpermendura, edhe ne rast se ato jane supozime ose te pabazuara. Per keto raste do te kryhet nje process investigimi dhe trajtimi i demit do te bazohet ne te dhenat e nxjerra nga ky investigim. Siguruesi nuk do te jete me pergjegjes per asnje dem ne rast se ai ka paguar shumen e percaktuar si limiti agregat ne formularin e polices.

Siguruesi nuk do te paguaje per shpenzime, te cilat jane kryer nga i Siguruari pa marre miratimin paraprak te tij.

Siguruesi nuk do te trajtoje asnjë dem pa marre pelqimin e te Siguruarit. Gjithësesi, nëse i Siguruarit do të refuzonte të ishte dakord me një zgjidhje të rekomanuar nga Siguruesi dhe do të zgjidhte të kundërshtonte dëmin ose të vazhdonte procedurat ligjore ne lidhje me kete dëm, atëhere pergjegjësia e Siguruesit per kete rast nuk do të kaloje vlerën në të cilën dëmi do të ishte në momentin e zgjidhjes sipas këtij rekomandimi duke përfshirë edhe shpenzimet e tjera në datën e refuzimit të tij.

4. Kërkesa per demshperblim

Ne kete police sigurimi kërkesa per demshperblim e bere nga nje pale e trete do te konsiderohet te jete bere sapo i Siguruarit dhe/ose nje nga perfaqesuesit e tij fillimisht:

- a) marrin nje kerkese me shkrim per deme te cilat mbulohen nga kjo police sigurimi;
- b) behet i vetedijshem per qellimin e cdo personi per te bere nje kerkese te tille ndaj tyre;
- c) behet i vetedijshem per cdo fakt, ngjarje ose rast, te cilat mund te japin shkak per ngritjen e nje kerkese per demshperblim ne nje te ardhme.

PERJASHTIME

Kjo police nuk do te demshperbleje te siguruarin per deme:

1. qe rrjedhin si pasoje e, qe bazohet ne ose qe shkaktohet nga nje Gabim i kryer jashte aktivitetit te te Siguruarit, te percaktuar ne formularin e polices, dhe jashte territorit te percaktuar ne kete formular.
2. te kryera bazuar ne shpifje, pergojime ose ankesa
3. te cilat rrjedhin si pasoje e nje gabimi te kryer me qellim, duke perfshire cdo akt mashtrues, te pandershem ose kriminal.
4. te shkaktuara si pasoje e humbjes ose shkaterrimit te nje dokumenti (origjinale, riprodhime) per shkak te veprimeve te Siguruesit ose punonjesve te te tij, te cilet i kane kryer keto veprime per llogari te te Siguruarit.
5. bazohen ne gjoba, deme ndeshkuese ose shembullore ose deme te tjera te ngjashme
6. shkaktohen ose vijne si pasoje e: luftes, pushtimit, akteve te armiqve te huaj, kryengritjeve, ose veprimeve te ngjashme me luften, luftes civile, grevave, kryengritjet ushtarake, rebelimeve, fuqive pushtuese ose ushtarake
7. bazohen ne garanci te shkruara te leshuara nga I Siguruarit ose punonjesit e tij ose ndonje person tjetër qe punon per llogari te te Siguruarit.
8. lidhen me falimentimin ose paaftesine e tij per te paguar.
9. qe lidhen me aktivitetin e te Siguruarit ose personave qe punojne per te ne fusha te ndryshme, nga ato te percaktuara ne formularin e Polices se sigurimit.
10. deme qe prekin personalisht te Siguruarin ose sendet e tij personale.
11. te ardhura nga parashikime ose vleresime financiare te marra bazuar ne keshillat e nje personi, te percaktuar si I Siguruar.